



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 701/4 prot.

Tiranë më 27.07.2020

VENDIM

Nr. 27, datë 27.07.2020

PËR KONTROLLUESIN "AUTO 1 ALBANIA" SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar (në vijim, "Ligji"), neneve 77 - 112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" (në vijim, "Kodi i Procedurave Administrative"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "AUTO 1 ALBANIA" SHPK (në vijim, "Kontrolluesi"),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 101, datë 12.06.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "Komisioneri"), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi "AUTO 1 ALBANIA SHPK".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi, ka si objekt të veprimtarisë tregtare dhënien e shërbimeve që nuk kërkojnë licencë, si këshillimi i biznesit, trajnimi, promovimi, tregtimi i mallrave të llojeve të ndryshme, ofrimin e një tregu interaktiv *online*, etj.

Në kuadër të marrëdhënies së punës, Kontrolluesi mbledh dhe përpunon disa kategori të të dhënave personale dhe sensitive për subjektet e të dhënave personale "kandidatë për punë", "punëmarrës" dhe "punëmarrës të larguar". Të dhënat përpunohen manualisht, si dhe nëpërmjet mjeteve elektronike.

Kontrolluesi, gjatë procesit të grumbullimit të të dhënave, për kategoritë e subjekteve të të dhënave “*kandidatë për punë*”, nuk informon këto subjekte mbi të drejtat e tyre sipas parashikimeve në nenin 18 të Ligjit dhe në Udhëzimin nr. 42, datë 22.07.2014, të Komisionerit “*Për përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 42*”), ndër të tjera, për mënyrën e përpunimit të të dhënave, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim dhe/ose fshirje të të dhënave të tij, si dhe të drejtën e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi iu mundëson atyre të njihen me të drejtat që iu janë akorduar me Ligj, si dhe iu mundëson, gjithashtu, ushtrimin e këtyre të drejtave në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi, nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket jetës private dhe, bashkë me të, të drejtës së subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.

2. Kontrolluesi ka lidhur një “Kontratë për ofrimin e shërbimeve” me mjeken e shoqërisë. Në kontratën e lidhur nuk parashikohen detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012, të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”);

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Detyrimet e përpunuesit duhet të jenë të përcaktuara qartë në një kontratë të shkruar midis kontrolluesit dhe përpunuesit, në zbatim të nenit 20 të Ligjit, si dhe në përputhje me Udhëzimin nr. 19.

3. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi e ka përbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Nga ana tjetër, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka kryer përditësimin përkatës për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket:

- (i) Deklarimin në rubrikën 3, “*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*” e tillë si “*kandidatë për punë*”;
- (ii) Deklarimin në rubrikën 6, “*Qëllimi i përpunimit*”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm, pasi i jep

mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore të Kontrolluesit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka paraqitur pretendimet me shkrim, si vijon:

- Kontrolluesi pretendon se aplikimet për punë kryhen nga portali “*njoftime.com*” në cilësinë e përpunuesit, por nuk ka vënë në dispozicion një kontratë ndërmjet tij dhe “*njoftime.com*”, ku përcaktohen kriteret për rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit gjatë përpunimit të të dhënave personale (kandidatë për pozicion të lirë pune).
- Kontrolluesi pretendon se kandidatët për pozicionin e lirë të punës pranojnë kushtet dhe e autorizojnë këtë të fundit për përpunimin e të dhënave personale përpara se të dërgojnë jetëshkrimet (CV) e tyre.

Në lidhje me këtë pretendim, Zyra e Komisionerit konstaton se formati i përgatitur nga Kontrolluesi nuk reflekton elementet e informimit sipas parashikimit në nenin 18 të Ligjit.

- Kontrolluesit pretendon se ka ndryshuar vetëm tipologjinë e kontratës me mjeken, por nuk ka ndryshuar aneksin 3 të saj, i cili mbetet në fuqi.

Zyra e Komisionerit konstaton se, në këtë rast, kemi të bëjmë me dy marrëdhënie juridike të ndryshme nëpërmjet palëve, në pozita të ndryshme.

Në rastin e kontratës së ofrimit të shërbimit lidhur me mjeken e shoqërisë, kjo e fundit nuk është më në pozicionin e punëmarrësit, por në cilësinë e ofruesit të shërbimit si person fizik tregtar, i cili, në bazë të nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit 19, është në pozitë e përpunuesit të të dhënave.

Nga ana tjetër, edhe aneksi i bashkëlidhur në kontratën e punës nuk është në përputhje dispozitën ligjore dhe udhëzimin e sipërpërmendur.

- Kontrolluesi pretendon se, sa i përket formularit të njoftimit, ai nuk ka në objektin e veprimtarisë së tij veprimtari marketingu, ndërkohë, ashtu siç është rezulton edhe në ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, Kontrolluesi ofron shërbime dhe ushtron veprimtari të tilla si këshillim biznesi, promovim, tregtimin të mallrave të llojeve të ndryshme, ofrimin e një tregu interaktiv *online*, etj.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të nenit 39, pika 1, germat “b”, “ç”, dhe “d” të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

*b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*

*ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.*

*d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2, të nenit 39, të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ajo lidhet me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 18, 20, 21, 29, 30, 39 (pika 1, germat “b”, “ç”, dhe “d”) si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

#### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa për përmbushjen në vijim të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave të përpunuara, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;
3. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përditësimin e njoftimit, në rast të ndryshimit të gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit;

4. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të ligjit, të përmbushet detyrimi i përcaktuar në pikën 2 më sipër, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni të këtij akti, si dhe të njoftohet Komisioneri për masat e marra.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit.
6. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më 27 07.2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

